



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 01-1912/14
Br. Prot. 01-1912/14
Prot No. 01-1912/14
Data 28-05-2014
Datum 28-05-2014
Date 28-05-2014

Nr. i faq. 02
Nr. pages 02

PRISHTINË

DATË/A:	27.05.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z.Lulzim Rafuna – Drejtor Gjeneral i Doganës se Republikës së Kosovës
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari ztr. Rafuna

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK-03-1901/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; *"bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave"*, (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Prandaj, bazuar në kërkesën tuaj, se a paraqet konflikt interesi angazhimi i juaj si Ekspert gjate ditëve te vikendit qe te ofroj mendime lidhur me draft ligjet ne Projektin e GIZ , në pajtim me

Faqe 1 nga 1

mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerr këtë :

OPINION :

Ekziston kufizimi në ushtrimin e funksionit publik si Drejtor i përgjithshëm i Doganës së Kosovës dhe angazhimit si ekspert në draft ligjet e projektit të Agjencionit ndërqeveritar Gjerman- GIZ.

Kjo situatë është e përfshirë në pjesën e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është përcaktuar si: Kufizimi i zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik nën 16.2 të Ligjit Nr.04/L-051), ku ndër të tjera thuhet : Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave .

Ushtrimi i funksioneve publike nënkupton që zyrtarët e lartë nuk duhet që të lejojnë që interesat e tyre private të bien në konflikt me funksionet e tyre. Ata duhet të shmangin konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real (faktik) apo i mundshëm.

Këtu do të njoftojmë cilat situata konsiderohen konflikt interesi për zyrtarin e lartë. Së pari është me rëndësi të citojmë nën 6 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përkufizon *çka është konflikti i interesit ?*.

Nga ky përkufizim kuptojmë, pos të tjerash, se; *“konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtëpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”*.

Po ashtu në Nenin 8 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit janë të përcaktuara detyrimet e zyrtarit të lartë për të shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Prandaj duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, ju rekomandojmë që të veproni konform këtij Opinioni të bazuar në Ligj, për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë në gjendje të konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me respekt,